

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Sahit Krasniqi , anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.M, M.M, për shkak të veprës penale trafikimi me qenie njerëzore nga neni 139 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarës A.R për veprën penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, PP nr. 168-2/2012 të datës 06.07.2012, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli Salihu, të akuzuarit A.M dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. G.R, të akuzuarit M.M dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. B.E, të akuzuarit A.R dhe mbrojtësi i saj me autorizim av. A.I, e dëmtuara V.K dhe mbrojtësi i viktimave I.T, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 30 prill, 16/27 dhe më 28 maj 2013 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A.M, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, data e lindjes ...në fsh. komuna e Skenderajt, ku edhe jeton, i martuar ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i gjendjes së mirë ekonomike.

M.M, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, data e lindjes ... në fsh. komuna e Ferizaj, ku edhe jeton, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republika së Kosovës.

A.R, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, data e lindjes, në fsh. Komuna Viti, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, e pa martuar, e gjendjes së mirë ekonomike, kamariere.

I

Në bazë të nenit 390 par. 1 nënpar. 3 të KPPK-së.

LIROHEN NGA AKUZA

A.M

1. Prej tetorit të vitit 2011 gjer më dt. 06.03.2012, në Ferizaj në lokalit "D", pronë e N. M. ka trafikuar të dëmtuarën V.K në atë mënyrë që e strehuar në katin e tretë të këtij lokali kinse për të punuar si k..... duke mbajtur lidhje dashurie dhe duke përdorur me kërcënime

duke mbajtur me kontrolle të rreptë me qëllim të shfrytëzimit e ka detyruar që të kryej marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm, siç është në lokalin “H” pronë e B. K. në lokalin “E”, pronë e K. M. pastaj në lokalin K” dhe “Sh” në Prelez, duke përfituar shuma të ndryshme parash dhe atë 50€ deri në 150€, të cilat para e dëmtuara ishte e detyruar t’ia dorëzoj të pandehurit.

- meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së.

M.M

2. Nga fillimi i shkurtit të vitit 2012 deri më dt. 07.03.2012 në lokalin – motelin “D”, pronë e tij me qëllim të prostitucionit ka lëshuar lokalin e këtij moteli dhe atë katin e tretë dhomën, V. K. në atë mënyrë që i ka mundësuar që të merret me prostitucion ku e njëjta ka kryer shërbime seksuale me klient të ndryshëm me para.

- meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

II

Konform nenit 389 par.1 pika 1 të KPPK-së

Ndaj A.R

REFUZOHET AKUZA

1. Ditën e pavërtetuar të vitit 2011 e deri më dt. 07.03.2012, e ka mundësuar ushtrimin e prostitucionit në atë mënyrë derisa ka punuar në motelin “....” në Ferizaj, pronë e të pandehurit M....., dy klientëve të cilët kanë kërkuar shërbime seksuale me para ua ka siguruar B. M. dhe A. P., e njëjta i ka thirr B. dhe A. P. dhe e ka vu në kontakt me të njëjtën edhe pse e ka ditur se është viktimë e trafikimi.

- meqë Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza për veprën penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP nr.168-2/2012 të datës 06.07.2012, ndaj të akuzuarit A.M, M.M për shkak të veprës penale trafikim me njerëz

nga neni 139 par.1 të KPK-së si dhe A.R, për shkak të veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

Me aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr. 577/12 të datës 09.08.2012, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarit A.M, M.M për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së si dhe A.R, për shkak të veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 30 prill, 16/27 dhe më 28 maj 2013, kurse Prokurori i Shtetit Florije Shamolli Salihu, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën,¹ ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës së ndryshuar në dispozitiv ndaj të akuzuarit A.M, për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së, duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim sipas ligjit.

Ndaj të akuzuarit M.M ka rikualifikuar veprën penale duke e akuzuar për shkak të veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim sipas ligjit.

Kurse sa i përket të akuzuarit A.R, Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza, për shkak të veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par 1 të KPK-së.

2. Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari A.M, në fillim të shqyrtimit gjyqësor e deri në fjalën përfundimtare nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së, kurse më tutje në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se prej fillimit

për herë të parë në Ferizaj kam ardhur diku në nëntor të vitin 2011 së bashku me V të cilën e kam njohur po në këtë vit, jemi ndalur në restorantin Sh në Ferizaj, ku V ka kërkuar punë e ka punuar si valltare në këtë restorant më vonë ka punuar edhe në restorante tjerë më kujtohet se ka punuar në restorant – kafe te B pastaj në motel E dhe në kafiteri të tjera. Me të njëjtën kemi qëndruar me një banesë me V tek stacioni i autobusëve dhe atë në banesën e K, dhe aty kemi banuar vetëm dy netë kurse V ka qëndruar më gjatë aty. Më vonë V ka filluar të banoj dhe punoj tek kafiteri a e B aty ajo është paguar 10€ në ditë, si dhe ashtu siç më ka thënë V për çdo pije ka marrë nga 1€, por pagesën për punën që ka bërë V unë asnjëherë nuk e kam pranuar nga B. Më vonë së bashku me V kemi banuar në hotelin “E”, kemi banuar rreth një muaj në atë vend, kurse në këtë kohë V ka punuar tek “K”, e që më vonë V dhe unë kemi filluar të banojmë në motel “D” unë së bashku me V aty kemi banuar rreth 3 javë kemi banuar së bashku por unë nuk kam qëndruar rregullisht aty me që nganjëherë kam shkuar në S aty ku është familja e që gjatë kësaj periudhe V ka punuar tek “K” kurse tek “D” ka punuar vetëm gjatë ditës për ta paguar qiranë përkatësisht për tu kompensuar për qira. Dhe kjo ka ndodhur pasi që V ka ndërprerë punën tek B, i cili konsideroj se ka manipuluar me familjarët e V ashtu që njëherë edhe i ka ofruar shumën prej 2000€ që të ndahet nga unë. Por unë as nga

¹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor gjyqësor, pjesën e ndryshimit të akuzës.

B dhe as nga personat e tjerë ku ka punuar V nuk kam marr para prej tyre për punën që ka bërë V.

Është e vërtet se unë me V. kemi pasur një lidhje dashurie po ashtu është e vërtet se e njëjta ndonjëherë më ka dhënë para dhe atë shuma të ndryshme 5€, 10€, e që në tërësi gjatë kësaj periudhe kohore mund edhe të ketë arritur shumën e përafërt prej 700€. Por këto unë nuk ia kam marrë të njëjtës në kërcenim por vullnetarisht mi ka dhënë por po shtoj edhe faktin se nganjëherë kur e njëjta ka mbetur pa para edhe unë i kam dhënë asaj me mundësitë që kam pasur. Personin me emrin B vetëm e kam dëgjuar si emër përmes V dhe është e vërtet se nga V e kam kuptuar se po don ti ndihmoj V dhe është e vërtet se unë i kam thënë V që t'ia marri 500€, por, unë edhe atëherë dhe edhe herave tjera nuk i kam thënë që të ketë marrëdhënie seksuale me atë person dhe as persona të tjerë. Po ashtu unë personalisht nuk kam qenë i pajtimit që V të punoj nëpër kafiterit ku ka punuar V por, e njëjta ka vendosur vetë dhe unë nuk kam mundur ta ndaloj edhe pse lidhja jonë nga ana ime ka qenë lidhje serioze dhe unë kam pasur qëllim martesë me të, përkundër faktit se unë jam i martuar.

Unë jam në njohuri për problemin që ka pasur V me M në momentin kur e njëjta nuk donte të punonte më në këtë restorant, unë një kohë nuk kam qenë se bashku me V por në atë kohë sipas asaj ajo kishte pranuar disa mesazhe kërcënuese nga M se donin të më rrihnin mua e që më pastaj unë jam takuar me V po ashtu jam takuar edhe me N dhe M dhe ne kemi hipur në taksì dhe jemi larguar nga aty kurse mesazhet kanë vazhduar që të vijnë derisa V rastin e ka paraqitur në polici. E që në përcjellje të tyre edhe ka marrë teshat nga restoranti ku kemi banuar së fundmi.

Unë është e vërtet se me nënën e V kemi biseduar në telefon dhe biseda në mes meje dhe asaj ka qenë më shumë rreth faktit se ne kemi pasur një lidhje dashurie në mes vete me V dhe është e vërtet se më ka thënë përmes telefonit që të mos vazhdoj lidhjen me të, me që unë as që e kam ndalur që të shkoj tek familja e saj ajo çdo javë ka shkuar atje, unë asnjëherë nuk kam biseduar me pronarë të kafiterive për pagesën e V por është e vërtet se gjatë një bisede që ka pasur V me M rreth kushteve të punës unë kam qenë prezent aty por nuk jam i sigurt se a ka qenë para fillimit të punës apo gjatë punës. Sa i përket ndërprerjes së punës tek M, V më ka thënë “ se nuk po dua të punoj më aty sepse nuk po dua me i mashtrua njerëzit më”. E unë nga V po ashtu kam kuptuar se me mashtrim kam kuptuar që V të pijë pije me klient për përfitim të pronarit dhe në momentin kur klientët kërkojnë që ajo të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta, kjo është dashur ti mashtroj, ti thotë naj ditë tjetër, apo të ngjashme, por, që të mos kryej marrëdhënie seksuale me ta. Unë kam njohuri edhe për faktin se V nga pronarët e restorantit të njëjtës i është thënë që të pijë me klientin Xh me që i njëjti edhe len bakshish se është i pasur, por diçka tjetër në atë aspekt unë nuk mund të sqaroj më tutje.

Po ashtu më kujtohet që gjatë bisedës që kam pasur me V e njëjta më ka thënë se sipas Et një plakë po don me u taku me të dhe ai do ti jap një bakshish deri në 1000€, unë nuk mund të përgjigjem konkretisht rreth kësaj porse ndoshta edhe mund ti kem thënë ato që mu lexuan nga Prokurori i Shtetit “nëse mundesh me ia nxjerr ato mirë edhe 150 thuj E që ti dhë ty, por nuk kujtohet që kanë dalur.” Mua tani ky detaj nuk më kujtohet.

Në pyetjet e av. G.R të tij, i akuzuari A.M përgjigjet: V unë e kam njohur edhe me nofkën “L”, pas kësaj pyetje av. kërkon që i akuzuari të shpalos krahun e djathtë në të cilën shifet se është e shkruar tatuazhi me shkronja të mëdha “L”, këtë tatuazh e kam vendosur gjatë periudhës së paraburgimit dhe këtë e kam shkruar nga dashuria që kam për L. Kurse gjatë kësaj periudhe V ka dërguar me sa unë e di edhe para.

Në pyetjet e drejtuara nga av. B.E, i akuzuari A.M përgjigjet: me M jam njohur në fillimi të vitit 2012. Gjatë vitit 2011 nuk kam pasur kurrfarë kontakti as telefonik e as drejtpërdrejtë me M. Sa i përket punëve që ka kryer V nëpër restorante ato punë kanë qenë të

njëjta si te “H” edhe në restorantin “D”. Që nënkupton se edhe pijet me klient i ka pirë në mënyrë të njëjtë si tek B përkatësisht 4€ i ka marrë pronari dhe 1€ V. Kurse sa i përket pijeve kanë pirë “Red Eagle”. Unë nuk kam dijeni se M e ka qar diku tjetër për të punuar V. Dhe unë deri më datën që e shpjegova për shkak të teshave që e shpjegova tjera probleme nuk ka pasur V me M. gjatë kësaj periudhe unë nuk kam parë që M ta ketë maltretuar apo të mos i ketë dhënë ushqim V. Sa i përket natës kur e ka lëshuar V punën kjo ka ndodh rreth orës 8:00, dhe unë kam pranuar menjëherë nga M me përmbajtjen se “ruju se po shkon diku tjetër V të punoj, se nuk e lejoj”, dhe në momentin kur e ka ndërprerë punën V së bashku me mua ka dal nga aty, me dt. 6.3.2012 ajo ka qenë me mua. Kurse para unë nuk kam pranuar nga M dhe as nuk i kam dhënë asnjëherë atij. Unë e kam parë përmbajtjen e SMS që i kanë ardh V nga M. Unë e di se V ka punuar në hotelin “D” kurse më herët ai ishte quajtur hotel “M”. E po ashtu sa i përket të akuzuarit M.M unë nuk kam njohuri se i njëjti i ka thënë ndonjëherë V që të ketë marrëdhënie seksuale me ndonjë person tjetër.

të nëntorit të vitit 2011 ka bashkëjetuar me Xh.G dhe atë në banesën në afërsi të K. në Ferizaj në periudhën kohore dikur rreth 4 muaj, me të cilën kanë pasur edhe marrëdhënie dashurie ndërmjet vete, duke pasur qëllim që edhe të martohen, po ashtu nuk e kontestoj faktin se gjatë kohës sa kanë bashkëjetuar kanë qëndruar edhe në motelin “F” dhe atë për 3-4 ditë, duke shfrytëzuar këtë motel për fjetje dhe atë posaçërisht në periudhën kohore kur Xh ka pasur mosmarrëveshje me vëllain e vet. Po ashtu nuk e kontestoj faktin se është munduar që të ndërmjetësoj për tejkalimin e mosmarrëveshjeve në mes Xh dhe vëllait të saj, e që në pamundësi të tejkalimit të tyre kanë vendosur që të bashkëjetojnë në banesën afër Kinemasë. I akuzuari më tutje në rrëfimin e tij shton se gjatë bashkëjetesë katër mujore në banesën e përbashkët nuk kanë pasur probleme në mes vete dhe se këtë fakt e kanë ditur edhe familja e tij edhe familja e të dëmtuarës dhe e njëjta me vullnet të plotë ka qëndruar në banesë. Kurse sa i përket të dëmtuarës H i akuzuari nuk e ka kontestoj faktin se e njëjta ka qëndruar për dy ditë në banesën e tyre, por, kategorikisht mohoj faktin se me të ka qenë në motelin “F”. Dhe përfundimisht në fjalën e tij përfundimtare ka propozuar gjykatës që ta liroj nga akuza meqë ndjehet i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari M.M, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale (trafikim me njerëz nga neni 139 par.1 të lidhur me nenin 23 të KPK-së), gjithashtu edhe mbas ndryshimit/rikualifikimit të veprës (mundësim i prostitucionit neni 201 par. 1 të KPK-së) ai nuk e pranon këtë veprë. Por nuk e kontestoj faktin se është pronar i motelit “F” në Ferizaj, i cili motel funksionon nga viti 2003, duke ofruar shërbime hoteliere dhe ushqim, e të cilat shërbime ofrohen për pushime ditore dhe për bujtje e që orari i rregullt i punës është 7:00-24:00h.

Ai gjatë mbrojtjes së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se para se të hynin në paraburgim U e kishte njohur vetëm si klient për periudhën kur kishte qenë me një femër në motelin e tij “F” ku edhe kishte bujtur një natë, po ashtu nuk mund ta dijë saktësisht se Uka a ka shkuar ndonjëherë tjetër me ndonjë femër aty, apo jo.

Sa i përket ditës kritike i akuzuari në mbrojtjen e tij më tutje shton se ka qenë në motel kur kanë shkuar policia aty dhe kanë kërkuar leje nga ai që të hyn brenda dhe gjatë kontrollimit të dhomave kanë gjetur në një dhomë një djalë dhe një vajzë e që përkundër

faktit se zakonisht personave që pushojnë u marrim paraprakisht shënimet e tyre dhe letërnjoftimet e që këtij personi nuk iu kishte marrë letërnjoftimit por nuk mund ta dijë se a iu është marrë emri apo jo.

I njëjti edhe në fjalën e tij përfundimtare ka përkrahur në tërësi fjalën nga avokati i tij mbrojtës duke kërkuar lirimin e tij nga akuza.

Po ashtu edhe i akuzuari A.R, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë gjithashtu duke deklaruar se ai punon vetëm si k.. në këtë hotel si dhe ditën kritike kur policia ka ardhur në restorant, derisa ka qenë duke punuar aty, me një tavolinë kanë qenë të ulur dy vajza dhe dy djem e më vonë njëri nga këta djemtë me njëren vajzë kanë kërkuar nga ai dhomë për pushim, djalit i ka kërkuar letërnjoftimin, por i njëjti nuk ka pasur, kurse nuk i ka marrë shënimet personale e që duke dalur nga moteli ka parë se aty kanë hyrë edhe tre persona tjerë ashtu që derisa ka shërbyer jashtë restorantit dhe kur është kthyer në restorant ka kuptuar se policia ishte duke bastisur restorantin përkatësisht ishte duke kërkuar persona në dhomat e katit të dytë. Atë ditë ka vërejtur se në restorant ka qenë personi të cilin e ka njohur si dashnorja e U dhe atë e ka njohur që nga koha kur i njëjti ka banuar aty me të në këtë restorantin dhe atë në periudhë prej 4-5 ditëve. Më tutje ka shtuar se dashnorja e U (Xh) nuk ka qenë shpesh në restorant por kur ka shkruar ka shkruar së bashku me U, kurse vajzën e re (është fjala për H) asnjëherë nuk e ka parë në restorant përveç ditës kur edhe është arrestuar nga ana e policisë.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që të akuzuarit A.M, M.M dhe A.R, nuk kanë pranuar fajësinë për asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëren me tjetren, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve;
- nga dëshmitë e të dëmtuarave/dëshmitareve Xh.G dhe H G;
- nga dëshmia e dëshmitarëve A Sh dhe A G;
- nga leximi në vërtetimin e marrjes së sendeve të dt. 22.01.2012
- nga leximi në shënimin zyrtar të hyrjes në lokal 20.02.2012
- nga shikimi në foto-dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës
- nga shikimi në regjistrin e thirrjeve telefonike sipas urdhërësës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë dhe atë prej dt. 25.09.2011 deri më datën 26.10.2011, nga telefoni mobil që ka shfrytëzuar i akuzuari U R 044/, 044/, nga tel mobil që ka shfrytëzuar i akuzuari M.M 044/dhe nga tel mobil që ka shfrytëzuar Xh.G 044/dhe 044/.

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Nga dëshmia e dëshmitarit A.Sh është vërtetuar se i njëjti ditën kritike ka shkuar në motelin “F” së bashku me shokun e tij Z.TH dhe aty gjatë bisedës së zhvilluar mes tij dhe Xh dhe H janë marrë vesh që me H të kryejnë marrëdhënie seksuale me pagesë prej 20€, e që paraprakisht para se të shkonin në dhomën e hotelit kishte bërë pagesë tek shefi i restorantit për shfrytëzim të dhomës në shumë prej 10€, e që me rastin e pagesës së kësaj shume nuk është kërkuar nga ai as dokument identifikim dhe as emri i tij e që pasi që kanë shkuar në dhomë të hotelit aty kanë shkuar policia dhe i kanë arrestuar.

Rrëfimi i këtij dëshmitar posaçërisht kanë qenë i rëndësishme përkitazi me rrethanën e vërtetimit të veprës penale që i përket të akuzuarit M.M dhe atë me faktin se Xh dhe H kishin qenë duke qëndruar në hotel (nuk kanë shkuar së bashku) e po ashtu edhe me faktin se marrëveshja për marrëdhënie seksuale mes tyre është bërë në hotel dhe në këtë pjesë dëshmia e tij është e besueshme, e saktë dhe reale, meqë ngjarjen e ka treguar në mënyrë të qartë dhe të hollësishme, për më tepër përmbajtja e kësaj dëshmie vërtetohet edhe nga i akuzuari A.R i cili përshkruan ngjarjen në mënyrë të ngjashme.

5.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit M.M dhe vlerësimi i tezës së mbrojtësit të tij av. A.A

Mbrojtja e të akuzuarit në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në paraqitjen se veprimi i tij ka qenë brenda veprimtarisë së rregullt hoteliere dhe se gjatë kësaj veprimtarie u ka ofruar klientëve shërbime në ushqim dhe fjetje pa përjashtuar edhe rastet e pushimeve ditore sipas kërkesave të klientëve të ndryshëm, veçanërisht duke potencuar faktin se është e zakonshme që personat të kërkojnë dhoma për pushim.

Por, mbrojtja e tij është në tërësi e paqëndrueshme për më tepër konfuze dhe dezorientuese e që nuk mbështetet në asnjë provë tjetër por përmes mbrojtjes së tij, e që në tërësi demantohet nga dëshmia e dëshmitarit A.Sh, i cili në mënyrë të qartë ka përshkruar në hollësi për marrëveshjen në mes tij dhe të dëmtuarave Xh dhe H.G, “...Xh e ka pyetur Hn për çmimin dhe tërë kohën është biseduar rreth shërbimeve seksuale që do ti ofronte H dhe Xh tërë kohën u folke rreth 30 -40 € e më pastaj Xh dhe Z janë marrë vesh që unë për shërbimet e ofruara nga H të paguaj shumë prej 20€ e më pastaj unë së bashku me Hn kemi shkuar në katin e dytë te restorantit. E më pastaj para se të shkonim në katin e dytë unë personalisht kam bërë pagesën tek shefi i restorantit dhe atë pagesë prej 10 € dhe kjo ka qenë pagesë për shfrytëzimin e dhomës, kurse H kam pasur t’ia jap shumën prej 20 € pasi të kryenim marrëdhënie seksuale.”²

Dhe nuk ka se si të shpjegohet ndryshe fakti se e tërë kjo bisedë është zhvilluar pikërisht në prezencë të të akuzuarit e po ashtu këtë fakt duke e ndërlidhur me deklarin e dëshmitares Xh.G ku deklaroi se “Unë kam dal edhe me persona tjerë, të cilët mua më kanë ftuar në telefon dhe personat të cilët më kanë pëlqyer kam kryer edhe marrëdhënie seksuale me ta, dhe atë njëherë tek “F” dhe dy herë te “K”, pagesën e ka bërë klienti dhe atë në kafiteri e më pastaj kemi kryer marrëdhënie seksuale, për të cilat edhe më kanë paguar këta persona, ndonjëherë klientët më kanë dhënë nga 5 € e ndonjë herë më kanë dhënë drekë”, që vërteton se H dhe Xh edhe herëve tjera kanë qenë në këtë motel dhe njëkohësisht janë marrë me prostitucion.

² Marrë nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor faqe 11.

Andaj është e pabesueshme se i akuzuari L të mos e ketë ditur se pikërisht në motelin e tij po ushtrohet prostitucion nga Xh dhe H dhe këtë e dëshmojnë edhe rrethanat në vazhdim: së pari ka qenë pronarë i këtij moteli, ka qenë prezent gjatë marrëveshjeve të arritura e sidomos me faktin se ditën kritike, ka inkasuar personalisht të hollat nga dëshmitari A.Sh, për shërbimet e ofruara- lëshimin e dhomave të motelit.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit M.M av. A.A³ të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar lirim nga akuza duke pretenduar se me asnjë provë nuk janë vërtetuar pretendimet e akuzës edhe sipas akuzës së ndryshuar, duke e pohuar faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka qenë i involvuar në kryerjen e kësaj vepre penale, për më tepër i njëjti është viktimë dhe tani akuzohet për një vepër penale të cilën nuk e ka kryer dhe nuk është dëshmuar se L ka pasur çfarëdo njohurie se dikush nga klientët e tij është duke kryer shërbime të prostitucionit. Kjo vërtetohet më së miri edhe nga fakti se në këtë lokal frekuentojnë rreth 70-130 mysafir dhe do të ishte e pamundur që i akuzuari ta dinte qëllimin e secilit klient.

Së pari është e nevojshme të analizohen dispozita e nenit 201 par. 1 të KPK-së me ç’rast përkufizohet:

“Kushdo që me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit dënohet...”

Por, Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

- se në cilësinë e pronarit të motelit ka ditur që ushtrohet prostitucioni nga ana e Xhs dhe Hs;
- se me dashje direkte ka pranuar të holla nga dëshmitari A.Sh i cili ka shfrytëzuar dhomën e motelit “F” dhe atë pas marrëveshjes që kanë bërë pikërisht në lokalet e këtij moteli ;

Por gjithsesi është e padiskutueshme se dispozita e lartcekur inkriminon veprimet në formë alternative e që një nga to është pikërisht veprimi të cilin e ka kryer i akuzuari dhe atë lëshimin e lokalit një personi tjetër për qëllime të prostitucionit, e që vërtetohet nga veprimet konkrete të tij të përshkruara hollësisht në pjesën që i referohet vlerësimit të mbrojtësit të të akuzuarit.

6. Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akuzuarit M.M

Siç është përshkruar edhe në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare ka ndryshuar akuzën, ashtu që të akuzuarin e ka akuzuar për shkak të veprës penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së

Gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit janë prezentë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par. 1 të KPK-ës, meqë i akuzuari me dashje direkte *“ka lëshuar lokalet”* (hapësirën e hotelit “F”) *“për qëllim të prostitucionit”*, dhe kjo më së miri është vërtetuar në momentin kur

³ Fjala përfundimtare e av. A.A e paraqitur në formën me shkrim.

dëshmitari A.Sh⁴ në hotel ka zhvilluar bisedë me Xh dhe H.G, në atë mënyrë që kanë negociuar çmimin e shërbimeve seksuale një herë në 40€ e më pastaj janë dakorduar për çmim prej 20€ e që më pastaj marrëveshja edhe është realizuar me shkuarjen në dhomën e hotelit dhe fillimin e marrëdhënieve seksuale me një kundër shpërblim prej 20€, e që e tërë kjo është bërë në mënyrë permanente dhe për një kohë të gjatë siç është specifikuar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës së dytë përkatësisht pjesës liruese të këtij aktgjykimi, Gjykata, ka bërë prezantimin e provave dhe ka dëgjuar dëshmitarët të përshkruar hollësisht në pjesën e parë të këtij aktgjykimi:

Gjykata në këtë pjesë të aktgjykimit gjithsesi e sheh të nevojshme të analizoj edhe sa i përket kësaj pjese dëshmitë e dëshmitarëve Xh, H.G dhe A.G, si dhe pjesërisht dëshminë e dëshmitarit A.Sh.

9. Vlerësimi i dëshmive të dëshmitarëve

Nga përmbajtja e dëshmisë së të dëmtuarës/dëshmitares Xh.G është vërtetuar se e njëjta kishte qenë e martuar në Sh dhe ishte ndarë nga bashkëshorti i saj duke u kthyer në vendlindjen e saj në fshatin D. për të jetuar tek familja e sajë për 3 muaj, e që pas një periudhe kohore ka filluar që të ketë raporte dashurie me Un përkundër faktit se edhe i njëjti ka qenë i martuar. Pas një kohe kanë filluar të banojnë së bashku në Ferizaj në afërsi të “I”, duke pasur marrëveshje që banesën ta paguajnë bashkërisht. Nuk e konteston faktin se me Un kanë qenë dy herë në motelin “F” ku në dhomat e këtij moteli edhe kanë pasur marrëdhënie intime, kurse sa i përket faktit se me persona tjerë ka pasur marrëdhënie intime nuk e konteston këtë, por duke shtuar se këto marrëdhënie i ka kryer edhe në motelin “F” dhe atë me persona të ndryshëm, e që këta persona për shërbimet e ofruara edhe e kanë paguar të njëjtën. Sa i përket ditës kritike ajo pohon se paraprakisht kanë qenë duke pirë kafe ajo H dhe dy djem të tjerë, e që pas pak H me njërin djalë kanë shkuar në një dhomë të motelit dhe në ndërkohë aty kanë arritur policia.

Kurse nga dëshmia e dëshmitares H.G, po ashtu vërtetohet se e njëjta ka qëndruar për 4 ditë në banesën e Xh dhe Ut dhe atë vetëm gjatë ditës kurse gjatë natës ka qëndruar tek shtëpia e burrit të saj në F, nuk pranon se ka kryer marrëdhënie intime me persona të tjerë përveç rastit-ditës kritike kur hallën e sajë – Xh një person e ka ftuar përmes telefonit, e pastaj që të dyja kanë shkuar në motelin “F” me taksì dhe gjatë qëndrimit në hotel ka takuar me një djalë të ri dhe pastaj kanë shkuar në katin e parë të hotelit dhe në dhomë, e më pastaj pas diku 5 min. ka shkuar policia dhe i ka arrestuar. Sa u përket raporteve mes Xh dhe U pohon se këto raporte kanë qenë të mira dhe kanë dashtë të martohen mes vehte.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtyre dëshmitarëve dhe nga fakti se dëshmitë e tyre pothuajse janë identike, i ka vlerësuar bashkërisht.

Gjithsesi nga fakti se ka pasur kontradikta të thella lidhur me deklaratimet e këtyre dëshmitareve gjatë procedurës hetimore dhe shqyrtimit gjyqësor (me që gjatë shqyrtimit gjyqësor në tërësi kanë mohuar deklaratimet e tyre gjatë procedurës hetimore), është e

⁴ Shih deklarinim e tij në faqen 11 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

nevojshme që dëshmitë e tyre të trajtohen në hollësi dhe në ndërlidhje logjike dhe të pashkëputura me provat tjera.

Së pari duhet theksuar se dëshmitë e dëshmitareve janë marrë konform dispozitive procedurale dhe në prezencë të mbrojtësve të tyre, që përjashton mundësinë që këto prova të shpallen të papranueshme por çështja e besueshmërisë së tyre paraqet një çështje delikate dhe mjaft të vështirë posaçërisht duke marrë parasysh karakterin, personalitetin dhe tiparet e këtyre dëshmitareve duke e ndërlidhur me shkallën e arsimimit, inteligjencën e mbi të gjithë këta faktor duhet trajtuar me kujdes integritetin dhe besueshmërinë e tyre, për më tepër vështirësi shtesë paraqesin edhe deklaratimet tyre kontradiktore.

Megjithatë Gjykata vlerëson se dëshmitë e tyre gjatë procedurës hetimore duhet vlerësuar në ndërlidhje me faktorët që domosdo kanë ndikuar në deklaratimet e tyre dhe atë :

- së pari dëshmitaret janë gjetur në një situatë të pafavorshme edhe për veten e tyre dhe gjithsesi edhe të frikësuara rreth situatës së tyre të paqartë si dhe njëra prej tyre e zënë në flagrancë duke kryer marrëdhënie seksuale në motel dhe është e pritshme që të japin deklaratime inkriminuese në lidhje me veprimet e të akuzuarit A.M;

- shumica e këtyre deklaratimeve janë të paqarta dhe tejet konfuze dhe që nuk përshkruajnë në mënyrë të detajuar se si ka rrjedhur ngjarja, “...gjithashtu më ka detyruar që të shkoj e më ka thënë se paratë, të cilat do të mi jepnin klientët t’ia sillja atij në banesë dhe në fund të gjitha paratë që i kam marrë ia kam dorëzuar U”,⁵ e që është deklaratë tepër e gjeneralizuar dhe nuk jep asnjë detaj tjetër të rëndësishëm dhe në kundërshtim të plotë me pjesën tjetër të këtij deklarami “... vëllai dhe kunata filluan të më shkaktonin probleme, pasi kuptuan që unë kisha filluar lidhjen me Un dhe për këtë arsye unë me Un jemi marrë vesh që ta gjenim një banesë për të bashkëjetuar, e pas kohësh ne kemi gjetur një banesë me qira në F”;⁶

- deklaratatë të thjeshta dhe tërësisht kontradiktore, vërehen edhe në dëshminë e dëshmitares H.G, e cila në njërin anë dëshmon se “asnjëherë në praninë time nuk e kam parë Un duke e maltretuar fizikisht apo në ndonjë mënyrë tjetër hallën time Xh”, për të vazhduar më tutje “as halla ime e as U nuk më kanë detyruar që të merrem me prostitucion”, e që në po të njëjtin deklaram shprehet se “halla më ka treguar se kishte frikë nga ai”;⁷

- në deklaratimet e tyre janë përdorur shprehje që janë të paqarta dhe të pakuptueshme për shkallën e arsimimit të tyre siç janë fjalët “detyrim”, “shfrytëzim”, “dhunë psikike”, “dhunë fizike” e “marrëdhënie seksuale me kompensim”, për të cilën gjatë shqyrtimit gjyqësor janë shprehur se nuk e dinë kuptimin e tyre.

Kurse sa u përket deklaratimeve të tyre “...kur vinte halla në banesë pas pak kohësh vinte edhe U dhe e kam parë se halla për një javë ia ka dhënë Ut 40€...”, e duke vazhduar më tutje “...Paratë në shumë prej 40€ të mijat dhe të saj ia ka dhënë në dorë Ut...”.⁸, e që nga ky deklaram i tyre nuk mund të trajtohet si element inkriminues i kësaj veprë penale, meqë paratë janë dhënë vullnetarisht dhe këtë fakt duke e ndërlidhur posaçërisht me faktin tjetër se në mes tyre (U dhe Xh) kemi pasur raporte të një bashkëjetese, këto mund të trajtohen vetëm si një ndihmë dhe solidaritet ndaj njëri-tjetrit e që në këto raste është plotësisht e plotësisht.

⁵ Shih deklaramin e dëshmitares Xh.G, dhënë gjatë procedurës hetimore në PPQ në Prishtinë

⁶ Po aty.

⁷ Deklarami i dëshmitares H Goliri dhënë gjatë procedurës hetimore në PPQ në Prishtinë.

⁸ Po aty

Por përkundër kësaj edhe gjatë këtyre deklarimeve hetimore nuk mund të nxirret ndonjë përfundim i qartë inkriminues se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë përkundrazi nëse trajtohen me kujdes dhe si tërësi edhe këto deklarime japin një argument të qartë se i akuzuari dhe e dëmtuara (H.G) në këtë periudhë kanë jetuar bashkërisht në një bashkësi tipike jashtëmartesore dhe se nuk është paraqitur diçka konkrete se i njëjti ka pasur sjellje agresive ndaj saj.

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitares A.G, dëshmia e saj nuk paraqet ndonjë relevancë të theksuar në këtë çështje penale pos që në mënyrë të qartë dhe të plotë ka vërtetuar raportet që kanë mbizotëruar në mes të akuzuarit A.M dhe të dëmtuarës Xh.G “...unë kam pasur njohuri se Xh dhe U kanë jetuar së bashku në Ferizaj, por nuk e di se në cilin vend, por atë e kam kuptuar nga bashkëshortja U, e cila më ka treguar se kunata ime – motra e burrit është duke jetuar me U”⁹ dhe se dëshmia e saj është e besueshme, objektive dhe reale, meqë ka paraqitur një fakt për të cilin pohon se e kanë ditur edhe të tjerët e edhe vet bashkëshortja e A.M.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit A.Sh, në pjesën e dëshmisë së tij që ndërlidhet me veprimet e të akuzuarit A.M, kjo pjesë e dëshmisë së tij është tërësisht e pabesueshme, sidomos thëniet e tij rreth bisedës që ka zhvilluar me H që i referohet raporteve në mes të Ut dhe Xh “...pak me ba mos me më ngu, mos me më shku për qefi të vras...”, se kjo dëshmi në të vërtetë është e pabesueshme vërtetohet edhe nga faktet që do ti prezantojmë më poshtë:

- së pari se deklarimi i tij është dhënë në një gjendje kur ka qenë i ndaluar nga ana e policisë (pikërisht për shkak se ai një ditë më parë kishte kërkuar para nga familja e A.M që të jep deklarim favorizues për të gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe tani në këtë gjendje gjithsesi është e pritshme që ta shfrytëzoj për deklarim jo favorizues)

- po ashtu edhe me faktin se këtë rrëfim nuk e ka prezantuar gjatë procedurës hetimore, kur kujtesa e tij ka qenë shumë më e freskët për këtë ngjarje, por e prezanton në hollësi në shqyrtimin gjyqësor, përkundër faktit se ka kaluar mbi një vit nga ngjarja e zhvilluar dhe mbi këto baza, Gjykata konsideron se ky është një fabrikim nga vetë dëshmitari.

Kurse nga leximi në vërtetimin e marrjes së sendeve, vërtetohet se me rastin e arrestimit nga i akuzuari L janë konfiskuar sendet e të cilat nuk paraqesin ndonjë element relevant në lidhje me përgjegjësinë tij penale.

Nga leximi në shënimin zyrtar të hyrjes në lokal, vërtetohet se me datën 20.02.2012 është bërë bastisja në banesë e A.M e që nga kjo bastisje nuk ka rezultuar të konfiskohet ndonjë provë relevante.

Ndërsa në shikimin në foto-dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës janë bërë fotografi në motelin F dhe në banesën e të akuzuarit A.M

Nga regjistri i telefonatave për numrin e telefonit që ka shfrytëzuar i akuzuari A.M, është provuar se në mes tij dhe Xh.G ka pasur kontakte telefonike, porse këto kontakte duke u ndërlidhur me faktin se të njëjtit kanë bashkëjetuar në mes vete, paraqesin diçka normale dhe nga to nuk mund të nxirret ndonjë konkludim që do të inkriminonte të akuzuarin, kurse sa i përket sms-ve, Gjykata i ka shpallur si prova të papranueshme.¹⁰ Pasi që ato janë nxjerrë me

⁹ Shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor faqe 7

¹⁰ Aktvendimi i datës 27.03.2013

shkelje të dispozitave ligjore (neni 153 par. 1 dhe 2 të KPPK-së përkatësisht në kundërshtim me nenin 258 par 2 nënpar 4 të KPPK-së) me që përmbajtja e sms-ve është urdhëruar nga ana e prokurorit.

10. Analiza e ligjit material

Trupi gjykues para vlerësimit të provave në këtë pjesë të aktgjykimit, e sheh të nevojshëm analizën dhe vlerësimin e përkufizimit të veprës penale të trafikimit, e cila është përkufizuar me dispozitën e nenit 139 (8) (1) i KPK-së e përcakton:

“Rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.”

Përkufizimi i trafikimit është i ndërlikuar, por bëhet i qartë nëse zbërthehet në tri komponentët kryesore e që janë të domosdoshme për ekzistimin e kësaj vepre penale dhe atë: *veprimi, mënyrat apo mjetet e paligjshme dhe për qëllim të shfrytëzimit.*

1. *Elementi i veprës apo veprimit përfshinë: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave.*
2. *Mënyrat apo mjetet e paligjshme përfshinë: kërcënimin ose përdorimin e dhunës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit të keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës apo të një pozite të ndjeshme apo me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që të ketë kontroll mbi personin tjetër¹¹.*

3. *Të ekziston qëllimi i posaçëm i shfrytëzimit: e që fjala “shfrytëzim” përkufizohet ajo që “përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.”*

Kurse në rastin konkret mungon së pari komponenti i parë elementi i veprimit dhe është e paqartë se cili është veprimi konkret i të akuzuarit, po ashtu ky element duhet të ndërlidhet me komponentën e dytë “*detyrimi*”, i cili nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme, e që në tërësinë e saj mungon edhe komponentja e tretë “*qëllimi i shfrytëzimit seksual*”, që duhet të jetë prezent për t’u realizuar kjo vepër penale, është e çartë se këto të tri komponentë duhet të ndërlidhen në mënyrë zingjyrore njëra me tjetrën dhe çdo shkëputje paraqet njëkohësisht mosrealizim të kësaj vepre penale.

11. Analiza e fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit

Po ashtu, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, i cili konsideron se nuk duhet t’iu besohet deklarimeve të dëshmitarëve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor nga fakti se janë pasojë e ndikimit nga ana e rrethit familjarë të viktimave, duke marrë parasysh mentalitetin e njerëzve që jetojnë në ambientin

¹¹ Ky kusht aplikohet vetëm në rastet kur viktima e trafikimit është e moshës madhore,

rural, nivelin e arsimimit të viktimave, i cili është edhe polic i Kosovës në stacionin policorë në Ferizaj,¹² e që nga fakti se të gjitha këto konstatime janë të natyrës hipotetike dhe të pambështetura pa asnjë konstatim bindës dhe të qëndrueshëm se i akuzuari në këtë periudhë kohore ka qenë në paraburgim dhe nuk ka ushtruar detyrën e tij si polic i Kosovës, si dhe nga deklaratimet e dhëna të dëshmitarëve lënë të kuptojmë se më të pabesueshme janë deklaratat e tyre të dhëna gjatë procedurës hetimore, ku ato pa u menduar mire dhe nga frika se mos akuzoheshin ato kishin shpikur edhe shumë gjëra, e në kontest të tyre ndikimi i tyre ishte i pamundur bazuar edhe në rrethanën se e dëmtuara Xh tani ishte duke jetuar në një qytet tjetër (Mitrovicë), andaj me gjithë respektin është në tërësi e pa pranueshme dhe atë nga fakti se nuk është e mundur që në tërësi të anashkalohen dëshmitë e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata vlerëson se dëshmitë e dëshmitarëve duhet të trajtohen në lidhshmëri njëra me tjetrën dhe se vlera e tyre provuese duhet të përcaktohet vetëm në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. E këtë duke e ndërlidhur posaçërisht me faktin se nuk duhet pasur prejudikim paraprak, por se të gjitha provat duhet të vërtetohen në mënyrë të pa dyshimtë si rezultat i një procesi që ndërlidhet në fazën e procedurës hetimore dhe fazën e shqyrtimit gjyqësor si dy faza tejet të rëndësishme për një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata në mënyrë të posaçme ka vlerësuar fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit sa i përket kësaj pjese të aktgjykimi dhe ka gjetur se nuk është paraqitur asnjë e dhënë bindëse për kryerjen e këtyre veprave penale sipas rikualifikimit juridik të paraqitur në fjalën përfundimtare, për më tepër nga analiza e fjalës përfundimtare po thuajse në tërësi është anashkaluar përshkrimi i veprimeve konkrete të të akuzuarit.

Në kontest të kësaj edhe vet përshkrimi i dispozitivit të akuzës në pjesën ku i referohet të akuzuarit A.M është i paqartë dhe konfuz në pikat që do ti paraqesim në vijim:

- së pari përveç që përdorë fjalinë “... i ka detyruar të ofrojnë shërbime seksuale me persona të ndryshëm me para...”, nuk përshkruan fare mënyrën e realizimit të detyrimit e po ashtu nuk përshkruan se kush janë personat e ndryshëm që u janë ofruar shërbimet seksuale, pastaj kundërvlerën që kanë paguar këta persona pasi bëhet fjalë për një periudhë prej 5 muajve(tetor 2011-20 shkurt 2013) nuk është konkretizuar qoftë edhe një veprim i vetëm i të akuzuarit;

- për të vazhduar më tutje “...e ka dërguar në motelin F në Ferizaj, për të ofruar shërbime seksuale me para të cilat para ia ka marrë në mbrëmje...”, as edhe njëherë nuk vërtetohet një pretendim i tillë se janë dërguar në motel nga i akuzuari dhe po ashtu nuk vërtetohet se ia ka marrë paratë dhe për çfarë shume të parave;

- dhe përfundimisht në mes tjerash përshkruhet “...kontroll të fortë mbi të si polic i Kosovës...”, e që tregon intencën që vëmendje qendrore ti kushtohet pikërisht pozicionit të tij të mëparshëm, e që kjo të përdoret si argument për fajësinë e tij, që është në kundërshtim të plotë me prezumimin e pafajësisë, meqë fokusi i Gjykatës duhet të jetë së pari në vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit e tek pas kësaj me rastin e matjes së dënimit të çmoj pozitën (funktionin) e tij si rrethanë lehtësuese apo rënduese.

¹² Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit në formë të shkruar

Një argument më tepër për aplikimin e këtij parimi të lartcekur është edhe fakti se këto parime janë aplikuar në shumë raste edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *në rastin Allonet De Ribemont v. Francë, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, No.308*, duke theksuar se: “...Në parim gjykatat nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mund të ketë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë së tij penale...”

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara për këtë pjesë të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në fjalë.

III

Sa i përket pjesës së tretë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit A.R, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së, meqë nga provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore të me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Në bazë të nenit 109 të KPPK-ës nëse konstatohen shpenzime eventuale për pjesët nën II dhe III të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR.nr.10/2013

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

1.